

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, bazuar në nenin 16 të Ligjit nr.03/L-079, për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut, nr.2006/50, për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private duke përfshirë pronën Bujqësore dhe ate Komerciale, kolegji në përbërje nga gjyqtarët, Ragip Namani kryetar i kolegjit, Beshir Islami dhe Jelena Krivokapić, anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, në çështjen juridike të **palës ankuese**;

**V.M. R.**, nga f..., me vendbanim në, ... R. Srbija, ankesa e ushtruar nga i autorizuari i tij, avokat D. V. ...

Kundër: **N.S.**, nga ..., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson, av. A. Gj. nga ...,

***Palë përgjegjëse,***

Duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur, kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/267/2015, të datës 30 Mars 2015 ,(lënda e regjistruar në AKP me numër KPA30851), pas shqyrtimit të mbajtur me datë, 26 shkurt 2020, merr;

**AKTGJYKIM**

- 1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e paraqitur nga V. R., e ushtruar nga avokati sipas autorizimit D. V., kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës, KPCC/D/A/267/2015, të datës 30 Mars 2015, për sa i përket kërkesës të regjistruar në AKP me numër, KPA30851.**
- 2. Vërtetohet Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/267/2015, i datës 30 Mars 2015, për sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP me numër, KPA30851.**

**Përmbledhje e çështjeve faktike dhe procedurale:**

1. Me datë 14 Qershor 2007, V. R., (në tekstin e mëtejme: pala ankuese), ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare (...), të bartësit të drejtës pronësore (BDP), në emër të nënës së tij S. R., me të cilën thekson se nëna e tij është pronare e ligjshme e pronës së kërkuar, përkatësisht e ngastrës kadastrale, numër ..., me kulturë arë e klasës së 3-të, me sipërfaqe prej 00.31.22 ha, e cila gjendet në vendin e quajtur „...”, f. . (në tekstin e mëtejme: prona e kërkuar).

2. Pala ankuese në kërkesë e shënon se, humbja e posedimit mbi pronën e kërkuar kishte ndodhur më 17 Qershor 1999, për shkak të konfliktit të armatosur të viteve 1998/1999. Po ashtu thekson se tani kjo pronë është uzurpuar nga pala e tretë, andaj kërkon ri posedimin e saj.
3. Në mbështetje të kërkesës së tij, në AKP , ka dorëzuar dokumentet si në vijim;
  - Vendimin nr..., të dt.09.04.1993, që tregon se BDP, S. R., është e ngarkuar me obligime tatimore për pronën e kërkuar.
  - Fletën Poseduese nr. ... të dt. 05.02.2003, që e paraqet si pronare të vetëm të pronës së kërkuar, nënën e ndjerë të palës ankuese S. R.
  - Certifikatën e të Drejtave Pronësore,( CDP),nr..., dt.15.02.2008, që e paraqet pronën e kërkuar në emër të palës përgjegjëse, (PP), N. S.
  - Padinë e dt. 03.08.2009, përpiluar nga “Danish Refugee Council”,(DRC), me të cilën kërkohet nga gjykata, anulimi i kontratës së shitblerjes të vitit 2002 në bazë të cilës në kadastrë ishte ndërruar pronari i pronës nga BDP e pretenduar, S.R., në palën përgjegjëse, N. S.
  - Letrën informuese për KPA-në, se DRC, e përfaqëson palën ankuese.
  - Aktgjykimin C. nr. 210/2009, të dt. 29.07.2011, sipas së cilit gjykata e shk. së parë, në Klinë vendos të anuloj kontratën e shitblerjes të dt. 15.10.2002, dhe e urdhëron kadastrin Klinë të fshijë nga regjistri si të pa saktë dhe ta regjistroj pronën e kërkuar përsëri në emër të ... të pretenduar, nënës së tij të ndjerë.
  - Deklaratën e dhënë me shkrim të dt.15.05.2007, sipas së cilës ai deklaron se, prona e kërkuar është shitur dhe është bartur në emër të PP, N. S., në mënyrë të pa ligjshme, në bazë të autorizimit të falsifikuar.
4. Njoftimi i pronës së kërkuar nga AKP është bërë me datë 21.11.2007, prona është gjetë të jetë livadh i pa uzurpuar nga askush. Notifikim tjetër është bërë për mes publikimit me datë 17 Qershor 2010, në gazetën e njoftimeve, nr. 2, dhe në buletinin pronësor zyrtar UNHCR, si dhe në organet te tjera vendore komunale dhe lokale.
5. N. S., (në tekstin e mëtejme: pala përgjegjëse, PP) për mes të autorizuarit avokat A. Gj. paraqitet në AKP, duke pretenduar të drejtë ligjore në pronën e kërkuar, dhe e nënshkruan formularin e pjesëmarrjes në procedurë. I njëjti pretendon se PP është pronare e ligjshme e pronës së kërkuar të cilën deklaron se e ka blerë në vitin 2002, nga ai si i autorizuar i palës ankuese.
6. Në mbështetje të pretendimeve PP, ka paraqitur dokumentet në vijim:
  - Aktgjykimin AC. Nr. 362/2011, të dt. 26.03.2012, me të cilin Gjykata e Qarkut në Pejë, e ka anuluar Aktgjykimin e gjykatës së shkallë së parë dhe e ka kthyer çështjen në rishqyrtim dhe rivendosje lidhur me pronën e kërkuar.

7. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së, kishte vërtetur se çështja sipas padisë së palës ankuese ende ishte e pa vendosur meritorisht nga gjykata, ndërsa në kadastër është vërtetuar *ex officio*, se ngastra e kërkuar ishte ende e regjistruar në emër të PP si pronare e vetme e saj.
8. I Kontaktuar nga sekretaria e AKP-së, pala ankuese kishte njoftuar se është kthyer në Kosovë në fshatin ..., por posedimin e pronës së kërkuar nuk po mund ta marrë sepse e njëjta është e uzurpuar nga PP, dhe është bartur në emër të saj në mënyrë të kundërligjshme, në bazë të autorizimit të falsifikuar, po ashtu kishte konfirmuar se është i njoftuar se Gjykata e Qarkut në Pejë e kishte anuluar aktgjykimin e gjykatës së shkallë së parë dhe çështja ishte ende e pa vendosur në ri procedurë.
9. Me 30 mars 2015, KKPK-ja me vendimin e vet KPCC/D/A/267/2015, e ka hedhur poshtë kërkesën e palës ankuese në mungesë të juridiksionit, duke theksuar se, pamundësia për ta ushtruar posedimin mbi pronën e kërkuar nuk rrjedh nga rrethanat që lidhen drejtpërsëdrejti apo që rezultojnë nga konflikti i armatosur. KKPK-ja vëren se, nga dëshmitë e paraqitura nga pala kërkuuese dhe pala përgjegjëse të cilat janë verifikuar, dhe të siguruara *ex officio* nga sekretaria ekzekutive, tregohet se pamundësia aktuale për të ushtruar të drejtat pronësore nuk ndërlidhen apo nuk është për shkak të konfliktit të viteve 1998/99, andaj rrjedhimisht kërkesa janë jashtë juridiksionit të komisionit dhe si të tilla hedhen. Në paragraf 20 të njëjtit vendim theksohet se, komisioni vëren se vendimi i tij nuk e cenon të drejtën e paraqitësit të kërkesës për të kërkuar ndihmë juridike që është në dispozicion në gjykatën kompetente.
10. Më 16 Dhjetor 2015, vendimi i ankimuar i KPCC, i është dorëzuar palës ankuese V. R.. I njëjti për mes të autorizuarit avokat D. V., ankesë ka ushtruar me datë 14 janar 2016, (e protokolluar me datë të njëjtë me vulë të AKP-së).
11. Me datë 29.04.2015, vendimi i është dorëzuar palës përgjegjëse N. S., për mes të autorizuarit të saj, avokat A. Gj.. Në shkresa të lëndës nuk ka prova se ndaj tij ka paraqitur ankesë.
12. Ankesa e palës ankuese, për përgjigje në ankesë i është dorëzuar PP me datë 20.09.2016, e njëjta nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

#### **Pretendimet e Palës Ankuese:**

13. Pala ankuese e kundërshton vendimin e KKPK-së, për shkak të; shkeljes së rëndë të drejtës materiale dhe procedurale, dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

14. Në arsyetim të ankesës ndër të tjera thekson se, me vendimin grupor kërkesat e vendosura individuale janë jo konkrete, nënçmuese, dhe të vendosura në mënyrë shumë të ngadalshme, se udhëzimi për tu gjendur në këtë procedurë i është dhënë palës ankuese në gjuhë angleze të cilën gjuhë nuk e kupton, se komisioni është shpallur jo kompetent duke theksuar se prona nuk është humbur si pasojë e konfliktit të viteve 1998/99, duke mos i analizuar dhe paraqitur si prova, çdo dokument të ofruar nga pala ankuese, se palës ankuese nuk i është mundësuar pjesëmarrja në procedurë dhe nuk i është paraqitur përgjigjja e palës uzurpuese të pronës së tij, etj.,
15. Propozon që ankesa të aprovohet, të prishet vendimi i ankimuar dhe çështja ti kthehet komisionit në rivendosje, ose i njëjti të ndryshohet dhe të pranohet kërkesa e parashtruesit të saj.

### **Arsyetimi ligjor**

16. Ankesa është e pranueshme, është paraqitur brenda 30 ditëve ashtu si është përcaktuar me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.
17. Gjykata Supreme, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumenteve në shkresat e lëndës, vendimit të apeluar dhe pretendimeve të palës ankuese, ka gjetur se ankesa është e pabazuar.
18. Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, KKPK-ja ka kompetencë për zgjidhjen e kërkesave që lidhen me konfliktin, që përfshijnë rrethanat që lidhen drejtpërdrejtë me ose që rezultojnë nga konflikti i armatosur i cili ka ndodhur në Kosovë. Prandaj paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në një urdhër për ri posedimin e pronës, nëse e vërteton të drejtën pronësore ose të drejtën e shfrytëzimit të pronës private, dhe se ai nuk është në gjendje ta ushtojë të drejtën e tillë pronësore, për shkak të rrethanave të lidhura drejtpërsëdrejti me ose që rezultojnë nga konflikti i armatosur i cili ka ndodhur në Kosovë në mes të 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.
19. Nëse komisioni verifikon se posedimi është humbur para ose pas datave të cekura si në nenin 3.1, si më lartë, apo që humbja e posedimit nuk ndërlihet me konfliktin do ta hedhë poshtë kërkesën mbi bazën ligjore nga neni 11.4 (b) të Ligjit nr.03/L-079.
20. Nga shkresat e lëndës vërtetohet dhe nuk kontestohet ndërmjet palëve që familja, përkatësisht nëna e palës ankuese ka qenë BDP, para, gjatë dhe pas viteve 1998/99,

- dhe prona në kadastër evidentohet në emër të saj deri në vitin 2002. Ndërsa pas rregullimit të trashëgimisë pas vdekjes së saj, pala ankuese është shpallur trashëgimtar i pronës së kërkuar.
21. Në anën tjetër pala përgjegjëse në ankesë thekson se pronën e kërkuar e ka blerë në vitin 2002 nga i autorizuari i palës ankuese sipas autorizimit të dhënë në Gjykatën Komunale ... Vr.... Shitblerja e pronës pretendohet të ketë ndodhur për mes kontratës së shitblerjes, në tetor 2002, e vërtetuar në Gjykatë Komunale në Klinë me nr. Vr.1846/2002, që kuptohet se kjo ka ndodhur mjaftë kohë pas konfliktit në mes të autorizuarit të palës ankuese si shitës i ngastrës së kërkuar dhe palës përgjegjëse. Në kadastër prona ishte regjistruar në emër të palës përgjegjëse sipas kontratës së cekur të shitblerjes.
  22. Pala ankuese (Kërkuese në AKP), e kundërshton shitjen dhe bartjen e pronësisë të pronës së kërkuar duke deklaruar se autorizimi në bazë të cilit është kryer transaksioni është i falsifikuar, andaj është bërë nënshkrimi i një kontrate të falsifikuar të shitblerjes dhe sipas një autorizimi të falsifikuar . Pala ankuese ka paraqitur prova se sipas padisë ndaj palës përgjegjëse për anulimin e kontratës së shitblerjes si e falsifikuar, është nxjerrë Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Klinë, nr. C.nr.210/2009, dt.29.07.2011, me të cilin është aprovuar kërkesë padia e tij, dhe është shpallë e pa vlefshme kontrata e shitblerjes e dt. 15.10.2002, lidhur me pronën lëndore dhe kadastrin është urdhëruar ta kthejë pronën në emër të pronarit të më parë S. R., nënës së ndjerë të palës ankuese.
  23. Në anën tjetër pala përgjegjëse e ka paraqitur Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac.362/11, të dt. 26.03.2012, me të cilin është prishë aktgjykimi i gjykatës komunale në Klinë C. Nr. 210/2009, i dt. 29.07.2011, dhe çështja është kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje.
  24. Pala ankuese në AKP, kishte konfirmuar se është i njoftuar që vendimi shkallës së parë i gjykatës Komunale në Klinë, ishte prishë nga Gjykata e Qarkut me vendimin e saj AC.362/11, dhe çështja ishte kthyer në rivendosje.
  25. Gjykata Supreme nën këto rrethana kur gjatë kontakteve me sekretarin e AKP-së dhe sipas pretendimeve në ankesë, nga pala ankuese kontestohen dokumentet e transaksionit të shitblerjes të lidhur në vitin 2002, lidhur me pronën e kërkuar, gjykata do të vërtetojë nëse KKKPK-ja ka pasur kompetencë për të vendosur në mënyrë meritore në këtë çështje, apo siq ka vendosur me hedhjen poshtë të kërkesës.

26. Gjykata Supreme vlerëson se, kontrata e shitblerjes përmes së cilës është bërë transaksioni i pronës së kërkuar është vërtetuar në gjykatë kompetente. Megjithatë nëse kontrata është ligjrisht e vlefshme dhe nëse autorizimi është i falsifikuar ose jo, ashtu si thekson pala ankuese, nuk është relevante dhe nuk mund të kundërshtohet në këtë procedurë në AKP, andaj nuk mund të shqyrtohet nga KKPK-ja, apo gjykata supreme, sepse nuk ndërlidhet me rrethanat dhe konfliktin e vitit 1998/99.
27. Kontrata e kontestuar e shitblerjes, pavarësisht nëse është e falsifikuar ose jo mban datën 15 tetor 2002, nga kjo tregohet se kontesti në fjalë i referohet bartjes së drejtës pronësore që ka ndodhur pas konfliktit në mes të palëve, andaj nuk është i ndërlidhur drejtpërsëdrejti me, ose nuk rezulton nga konflikti i armatosur, i cili ka ndodhur në Kosovë në vitin 1998/99. Transaksioni nëse është i ligjshëm apo jo, duhet të vërtetohet në procedurë gjyqësore në gjykata me kompetencë të rregullt.
28. Gjykata Supreme e Kosovës mori në shqyrtim edhe pretendimet e palës ankuese sa i përket përdorimit të gjuhës në procedurë në AKP, ashtu si thekson në ankesë, “lidhur me dërgimin e udhëzimit për gjindshmërinë në këtë procedurë konfuze dhe dorëzimin e dokumenteve palës kërkuese në gjuhë angleze të cilën nuk e kupton”, etj., këto theksime në ankesë kolegji i vlerëson se nuk janë të qëndrueshme apo të bazuara, sepse të gjitha shkresat e AKP-së me rëndësi vendimtare në këtë lëndë si dhe Vendimi i KKPK-së, (ai individual dhe i përbashkët), janë të shkruara në të tri gjuhët, prandaj gjykata nuk gjeti se janë shkelur dispozitat e nenit 3 të Urdhërësës Administrative UNMIK/Urdhërësë/2007/5 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, e cila parasheh në nenin 3.1 “*Gjuhët të cilat do të mund të përdoren nga Agjencia Kosovare e Pronës në të gjitha procedurat e paraqitura në bazë të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50 do të jenë ato shqipe, serbe dhe angleze*”. Kurse neni 3.2 parasheh se “*Çdo person, cili merr pjesë në procedurën para Komisionit dhe procedurën e ankesës para Gjykatës Supreme që nuk flet gjuhën e procedurave, ka të drejtë të flasë në gjuhën e tij/saj dhe të drejtën e informimit pa pagesë përmes përkthimit gojor, të dëshmimeve, fakteve dhe procedurës*”. AKP-ja ka respektuar këtë dispozitë ligjore, kurse shkresat e dorëzuara nga pala ankuese kanë qenë në gjuhën serbe dhe si të tilla i janë dorëzuar palëve përgjegjëse. Njësoi edhe me shkesat e palëve tjera është vepruar. Ligji nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, në nenin 97 parasheh se, vetëm “Letërthirrjet, vendimet dhe shkresat tjera gjyqësore u dërgohen palëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në procedurë në gjuhën që është në përdorimin zyrtar në gjykatë”. Provat që i bashkëngjiten kërkesave të palëve nuk përkthehen për nevojat e palëve tjera përveç për Gjykatën.
29. Nga të lartë cekurat gjykata supreme arrin në përfundim se vendimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje ligjore apo me vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike ashtu si theksohet në ankesë, andaj vlerëson se KKPK-ja ka marrë vendim të drejtë dhe ligjor, me hedhjen poshtë të kërkesës, në përputhje me nenin 11.4., të Rregullores

së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, sepse e njëjta nuk bie brenda kufijve të juridiksionit dhe kompetencave të KKPK-së, andaj vendimi i këtij organi vërtetohet.

30. Në bazë të asaj që u tha më lart dhe në kuptim të nenit 13.3.(c), të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, dhe nenin 166, paragraf 2, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**Këshillë ligjore:**

31. Sipas nenit 13.6, të Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë, andaj nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË  
GSK-KPA-A-078-2016, me datë 26 shkurt 2020

Bashkp. Profesional,  
Sherif Krasniqi

Kryetari i Kolegjit,  
Ragip Namani